

VENDIM
Nr. 709, datë 23.11.2018

**PËR NJË SHITESË FONDESH, NGA FONDI REZERVË I BUXHETIT TË SHTETIT,
MIRATUAR PËR VITIN 2018, DHE RISHPËRNDARJE TË FONDIT TË PAGAVE PËR
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË TATIMEVE, NË BUXHETIN E MIRATUAR
PËR VITIN 2018**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 11 e 13, të ligjit nr. 190/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2018, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, i shtohet fondi prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh për financimin e projektit “Implementimi në sistemin tatimor *e-taxation* të ndryshimeve ligjore të paketës fiskale 2019”.

2. Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2018, në zërin “Shpenzime personeli”, i shtohet fondi prej 23 000 000 (njëzet e tre milionë) lekësh për pagesën e punonjësve me kontratë për periudhën nëntor–dhjetor 2018.

3. Efekti financiar prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh, për financimin e projektit “Implementimi në sistemin tatimor *e-taxation* të ndryshimeve ligjore të paketës fiskale 2019”, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2018.

4. Efekti financiar prej 23 000 000 (njëzet e tre milionë) lekësh, për pagesën e punonjësve me kontratë, sipas pikës 2, të këtij vendimi, të përballohet nga zëri “Shpenzime korrente”, i aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, miratuar për vitin 2018.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama